



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/20
Datë: 22.05.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 maj 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve dhe të transkripteve të mbledhjeve: të tetë (8) dhe të njëmbëdhjetë (11) të Qeverisë.
2. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve të mbledhjeve: të dymbëdhjetë (12), të trembëdhjetë (13), të katërbëdhjetë (14), të pesëmbëdhjetë (15), të gjashtëmbëdhjetë (16), të shtatëmbëdhjetë (17) dhe të tetëmbëdhjetë (18) Elektronike\Korresponduese të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/20
Datë: 22.05.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 12, paragrafi 1, nënparagrafit 1.7 të Ligjit Nr. 08/L-067 për Inspektimet, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 maj 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti i Përgjithshëm Vjetor mbi Inspektimet.
2. Raporti i Përgjithshëm Vjetor mbi Inspektimet nga pika 1. e këtij Vendimi, publikohet në faqen zyrtare të Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm.
3. Obligohet Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm në kuadër të Zyrës së Kryeministrit për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/20
Datë: 22.05.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, bazuar në paragrafët 3, 4 dhe 5 të nenit 48 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, nenit 14, paragrafët 2, 3, 4 dhe 5 të Rregullores Nr. 07/2025 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 maj 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Emërohet Komisioni i Pranimit për kategorinë e lartë drejtuese, për pozitën Drejtor Ekzekutiv i Agjencisë së Investimeve dhe Eksportit në këtë përbërje:

- 1.1 Naim Gashi, kryesues;
- 1.2 Labinot Zeqiri, anëtar;
- 1.3 Besa Bytyqi - Baraliu, anëtare;
- 1.4 Arlinda Kamberaj, anëtare;
- 1.5 Valdete Avdyli, eksperte e jashtme, anëtare.

Përbërja e anëtarëve zëvendësues të Komisionit:

- 1.1 Leonita Shabani - Mullarama;
- 1.2 Irfan Lipovica;
- 1.3 Edi Gusia;
- 1.4 Arife Kodraliu;
- 1.5 Florije Manaj - Zogaj, eksperte e jashtme.

2. Komisioni i Pranimit për kategorinë e lartë drejtuese zgjidhet ad-hoc nga lista e kandidatëve potencialë për çdo pozitë, i emëruar sipas pikës 1. të këtij Vendimi.
3. Anëtar nga pika 1.5 e këtij Vendimi ka të drejtën e kompensimit, sipas nenit 14, paragrafit 10 të Rregullores Nr. 07/2025 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil.
4. Komisioni i Pranimit për kategorinë e lartë drejtuese, i emëruar sipas pikës 1. të këtij Vendimi, detyrat dhe përgjegjësitë do t'i ushtrojë në pajtim me Ligjin Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, Rregulloren Nr. 07/2025 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha Ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/20
Datë: 22.05.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neneve 15 dhe 16 të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 maj 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Kërkesa për shpalljen me interes publik për bartjen e pronës komunale, në pronësi të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit për zhvillimin e Parkut Industrial dhe Teknologjik në Komunën e Gjilanit.
2. Sigurimi i bazës pronësore për zhvillimin e Parkut Industrial dhe Teknologjik në Gjilan, si projekt me interes të veçantë strategjik dhe me interes të përgjithshëm dhe publik për Republikën e Kosovës.
3. Obligohen Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit dhe institucionet e tjera kompetente për zbatim të këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/20
Datë: 22.05.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 22 paragrafit 1, të Ligjit Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19, të datës 14.07.2021, lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, i ndryshuar dhe i plotësuar me Vendimin Nr. 12/31, të datës 25.08.2021, Vendimin Nr. 01/49, të datës 17.12.2021, Vendimin Nr. 15/62, të datës 23.02.2022, Vendimin Nr. 04/90, të datës 26.07.2022, Vendimin Nr. 31/99, të datës 30.09.2022, Vendimin Nr. 20/140, të datës 26.04.2023, Vendimin Nr. 23/159, të datës 13.09.2023, Vendimin Nr. 42/178, të datës 13.12.2023, Vendimin e Qeverisë Nr. 43/178, të datës 13.12.2023, Vendimin e Qeverisë Nr. 01/241, të datës 27.12.2024, dhe Vendimin e Qeverisë Nr. 02/270, të datës 07.10.2025, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 maj 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet ndarja e mjeteve buxhetore në shumën prej 1,000,000.00€ (një milion eurosh) për zbatimin e Masës 3.4 - Kuponë ushqimi për familjet në nevojë, në kuadër të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, për mbulimin e kostos sipas thirrjes së shpallur nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, me datë 24.10.2025.
2. Mjetet sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren nga Ministria e Financave, me kod 201, nga nënprogrami "Programi i Ringjalljes Ekonomike", me kod 29300, nga kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", dhe ndahen në Ministrinë për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare, me kod 209, në nënprogramin "Departamenti i Skemave Sociale" me kod 01700, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
3. Mjetet sipas këtij Vendimi transferohen, buxhetohen dhe alokohen në kodin e përcaktuar (00098) në programin përkatës, pas përfundimit të procesit dhe aprovimit të listës së përfituesve, sipas kriterëve dhe kushteve të përcaktuara për masën përkatëse.
4. Obligohen Ministria e Financave dhe Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare për zbatimin e këtij Vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/20
Datë: 22.05.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 16, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/L-045 për Partneritet Publiko-Privat, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 maj 2026, merr këtë:

V E N D I M

- Emërohet Komiteti për Partneritet Publiko-Privat, në këtë përbërje të anëtarëve të përhershëm, si në vijim:
 - Hekuran Murati, Ministër i Financave, kryesues;
 - Mimoza Kusari - Lila, Ministre e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, anëtare;
 - Dimal Basha, Ministër i Infrastrukturës dhe Transportit, anëtar;
 - Artane Rizvanolli, Ministre e Ekonomisë, anëtare;
 - Elbert Krasniqi, Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal, anëtar.
- Obligohen Ministria e Financave dhe institucionet e tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.
- Shfuqizohet Vendimi i Qeverisë Nr. 04/03, i datës 02.04.2021, për emërimin e anëtarëve të Komitetit për Partneritet Publiko-Privat.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/20
Datë: 22.05.2026


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neneve 4, 7, 8, 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 maj 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejshëm i Kërkesës së Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, për shpronësim për interes publik të pronave ish-shoqërore "Virgjinia" dhe "Metaliku", që janë nën menaxhimin dhe administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, të cilat preken nga ndërtimi i zonës industriale në Komunën e Gjakovës, sipas tabelave të bashkëngjitura këtij Vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme/Ministria e Financave, në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përlogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, në pajtim me nenin 8, paragrafi 8, të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, bën shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
4. Kompensimi i pronave do të bëhet nga subjekti kërkues - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, dhe Ministria e Financave.

6. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/20
Datë: 22.05.2026


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neneve 14 dhe 22, të Ligjit Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 maj 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Pakoja për Përballje me Inflacionin 2.0, me masat si në vijim:
 - 1.1. Mbështetje e njëhershme në vlerë prej 100€ (njëqind eurosh) për përfituesit e skemave pensionale, në muajin maj 2026, që i përmbushin kriteret për përfitim, sipas këtij Vendimi;
 - 1.2. Mbështetje e njëhershme në vlerë prej 100€ (njëqind eurosh) për fëmijët që janë përfitues të skemës së shtesave për fëmijë, në muajin maj 2026, që i përmbushin kriteret për përfitim, sipas këtij Vendimi;
 - 1.3. Mbështetje e njëhershme në vlerë prej 100€ (njëqind eurosh) për të gjithë të punësuarit e deklaruar në muajin prill 2026, me të ardhura mujore më pak se 1,000€ (njëmijë euro), që nuk janë në listën e pagave që paguhen nga buxheti i shtetit dhe që i përmbushin kriteret për përfitim, sipas këtij Vendimi;
 - 1.4. Mbështetje e njëhershme në vlerë prej 100€ (njëqind eurosh) për të gjithë studentët aktivë dhe të rregullt, në vitin akademik 2025/2026, në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë, që i përmbushin kriteret për përfitim, sipas këtij Vendimi.
2. Mjetet për mbulimin e kostos së masave, sipas pikës 1. të këtij Vendimi, sigurohen si vijon:
 - 2.1. Për pikat 1.1. dhe 1.2. të këtij Vendimi, mjetet sigurohen përmes alokimit të parakohshëm të mjeteve nga nënprogramet përkatëse. Autorizohet Thesari i Kosovës në Ministrinë e Financave që t'i ndërmarrë hapat e nevojshëm për alokim të mjeteve sipas përlllogaritjeve të bëra nga Ministria për Punë, Familje dhe Vlera të Luftës Çlirimtare;
 - 2.2. Për pikën 1.3. të këtij Vendimi ndahen 25,000,000€ (njëzetepesë milionë euro). Mjetet merren nga Ministria e Financave, me kod 201, nënprogrami "Programi i Ringjalljes Ekonomike", me kod 29300, nga kategoria "Subvencione dhe Transfere", dhe ndahen në Ministrinë e Financave, me kod 201, në nënprogramin "Thesari", me kod 11200, në kategorinë "Subvencione dhe Transfere";
 - 2.3. Për pikën 1.4. të këtij Vendimi ndahen 7,000,000€ (shtatë milionë euro). Mjetet merren nga Ministria e Financave, me kod 201, nënprogrami "Kontigjencat në Ministrinë e Financave", me kod 28900, nga kategoria "Subvencione dhe Transfere", dhe ndahen në Ministrinë e Financave, me kod 201, në nënprogramin "Thesari", me kod 11200, në kategorinë "Subvencione dhe Transfere".

3. Asnjë përfitues nuk mund të përfitojë më shumë se një herë nga masat, sipas pikës 1. të këtij Vendimi.
4. Autorizohet Ministri i Financave që nëpërmjet vendimeve të veçanta, të përcaktojë kriteret, procedurën dhe veprimet përkatëse për realizimin e masave të përcaktuara në pikën 1. të këtij Vendimi.
5. Obligohen Ministria e Financave dhe Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare për zbatimin e këtij Vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë